



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

**Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport,
Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Mbledhja nr. 81

Prishtinë, më 05.06.2013 ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302

PROCESVERBAL

**I mbledhjes së Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike,
Qeverisje Lokale dhe Media**

Në mbledhje morën pjesë : Idriz Vehapi, Eqrem Kryeziu, Xhevahire Izmaqi, Ramë Vataj, Sadri Ferati, Lirije Kajtazi, Teuta Haxhiu, Jeton Svirca, Afrim Kasolli.

Mungoi: Enis Kervan dhe Milivoje Stojanovic.

Në mbledhje morën pjesë : Gjejlane Hoxha-udheheqese ekzekutive në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, zyrtar nga presidenca, përfaqësues të shoqërisë civile dhe zyrtarët për media të Kuvendit.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Lule Ymeri, Shaip Goxhuli dhe Valbona Makolli-praktikante.

Mbledhjen e kryesoi : Idriz Vehapi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, mbajtur me 15.05.2013;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës për vitin 2012 i Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturorë;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, mbajtur me 15.05.2013

Procesverbali i mbledhjes së Komisionit, mbajtur me 15.05.2013 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës për vitin 2012 i Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore

Kryetari theksoi se anëtarëve të Këshillit u ka skaduar mandati dhe në mungesë të procedimit të ligjit të ri për Trashëgimin Kulturore, Këshilli nuk ka asnjë anëtar në përbërje të tij, dhe kërkoi nga udhëheqësja ekzekutive e Këshillit të shpjegoi raportin e dërguar në Komision.

Gjejlane Hoxha njoftoi se kanë e punuar draft ligjin për trashëgimi kulturore, ku janë të precizuara të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit si dhe procesi i zgjedhjes së anëtarëve të tij. Aspekt i ndjeshëm është çështja e planifikimit në territor dhe mungesa e kapaciteteve për trashëgimi kulturore në ministri dhe institucione tjera përkatëse për trashëgimi. Njoftoi se Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, përmes Asacionit të Arkitekteve të Kosovës është anëtarësuar në Unionin Ndërkombëtar të Arkitektëve me seli në Paris i cili bashkëpunon me Unescon, ndërsa është e emëruar drejtor i programit për trashëgimi kulturore për 32 shtete.

Kryetari theksoi se po diskutohet raporti i një organi që nuk ekziston, kërkoi të përshpejtohet procedura e sjelljes së ligjit të ri ku do të përcaktohen procedurat e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit sepse ligji aktual nuk e përcakton këtë.

Lirije Kajtazi mendoi se mungesa e përmbushjes së detyrimeve ligjore ka reflektuar në mos përmbushje të detyrave. Duhet të precizohen kompetencat e institucioneve që merren me trashëgimi, ka ngecje në përmbushje të detyrave, ka nevojë të punohet më shumë dhe kërkon që sa më shpejt të procedohet ligji i ri.

Sadri Ferati kishte vërejtje të shumta në raport. Ka dilemë se a duhet të shqyrtohet raporti që nuk ka kaluar në Këshill. Theksoi se Këshilli nuk ka kryetar, nuk ka anëtar dhe kërkoi të debatohet më gjerë për këto çështje.

Teuta Haxhiu theksoi se nuk ka Këshill, sekretariati është i ndarë nga Këshilli dhe Komisioni nuk duhet të shqyrtojë raporte të sekretariatit por të Këshillit, i cili në fakt nuk ekziston.

Raporti së pari duhet të miratohet në Këshill.

Kërkon që të bëhet ndryshimi i ligjit për Trashëgiminë kulturore në mënyrë që të ketë bazë ligjore për emërimin e anëtarëve të Këshillit.

Jeton Svirca tha se më shumë do ti ndihmojnë Këshillit nëse nuk e miratojnë këtë raport, me qëllim që Kryesia dhe ministria të marrin masa për zgjedhjen e kësaj çështjeje.

Xhevahire Izmaku kërkoi që raporti të mos miratohet dhe të diskutohet se si të zgjidhet kjo çështje.

Kryetari theksoi se në ligj duhet të ceket procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit. Kuvendi zgjedh anëtarët e bordeve dhe të institucioneve të tjera, por në këtë rast mënyra e zgjedhjes duhet përcaktuar me ligj.

Me ligjin për Trashëgiminë kulturore i cili është në fuqi nuk përcaktohet mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit.

Eqrem Kyeziu tha se raporti nuk është dashur të shqyrtohet nga komisioni, Këshilli është inekzistent dhe lidhur me këtë duhet të raportoi vetë Këshilli e jo administrata e tij.

Më tej tha se ky raport duhet të merret si shkak për diskutim në Kuvend lidhur me funksionalitetin e tij.

Afrim Kasolli tha se ka dilemë për raportin dhe nuk duhet të diskutohet sepse Këshilli ska legjitimitet. Instanca autoritative që e legjitimon këtë raport nuk ekziston dhe i njejtë nuk është dashur të vijë në Kuvend për shqyrtim.

Kryetari theksoi se raporti si i tillë që nuk është raport i Këshillit, por i ekzekutivit i cili është i ndarë nga Bordi. Rregullorja dhe ligji në fuqi, obligojnë që Komisioni funksional të shqyrtojë raportet e organeve të pavarura nga fushëveprimtaria e tij.

Pas debatit të zhvilluar lidhur me këtë çështje, Komisioni konstatoi se Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor, nga gjysma e vitit 2012 nuk është funksional për shkak se anëtarëve të tij iu ka skaduar mandati ligjor.

Komisioni, me shumicë votash vendosi që ti rekomandon Kuvendit mos miratimin e këtij raporti.

4. Të ndryshme

Në këtë pikë të rendit të ditës u diskutua për pjesëmarrjen në Konferencën e organizuar nga OSBE dhe KPM lidhur me procesin e digjitalizimit, që do të mbahet në Prevallë me datë 10 dhe 11 Qershor 2013..

Xhevahire Izmaku tha se anëtarët e Komisionit me këtë rast do të informohen më gjërësisht me procesin e digjitalizimit dhe se është rast i mirë për informim për këtë proces.

Mbledhja përfundoi në ora 12:30

Përgatitur nga :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**KRYETARI I KOMISIONIT,
Idriz Vehapi**